

# Ligj për punësimin e personave me hendikep

(Friday, 16 December 2005) - Shkruar nga Administrator - Azhuruar së fundi (Friday, 16 December 2005)

("Gazetë zyrtare e Republikës  
së Maqedonisë" nr. 44/2000)

## - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni

1

Me

këtë ligj rregullohen kushtet e veçanta për punësimin dhe punën e personave të hendikepuar: kur pamvarësisht kryejë profesion ose veprimtari, te punëdhënësi ose në vetinë e punëdhënësit, si dhe kushtet për themelimin dhe privilegjet për punën e shoqatës tregtare për punësimin e personave të hendikepuar (në tekstin e mëtutjeshëm: shoqatë mbrojtëse).

Neni

2

Person

me hendikep në kuptim të këtij ligji është personi hendikepi i të cilit është vërtetuar nga organi kompetent. Neni

3

Personave

me hendikep dhe shoqatave mbrojtëse ju zbatohen kontrata ndërkombëtare të ratifikuara në pajtueshmëri me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë.

## - KUSHTE TË VEÇANTA DHE PRIVILEGJE PËR PUNËSIM

### DHE PUNË TË PERSONAVE ME HENDIKEP

Neni

4

Kushte të veçanta dhe privilegje për punësimin dhe punën e personit me hendikep janë:

- krijimi

i kushteve për punë dhe adaptim të vendeve të punës;

- lirim

nga tatimet dhe sigurimi i mjeteve për kontribute dhe

- përkrahje

finansiare për punësimin.

Neni

5

Gjatë

punësimit të personit me hendikep, punëdhënësi

është i obliguar të krijojë kushte për punë dhe adaptim të vendit të punës mvarësisht nga vendi i punës, lloji dhe shkalla e arsimimit dhe lloji dhe shkalla e hendikepit i personit me hendikep i cili punësohet.

Neni

6

Kompenzimi

i harxhimeve për krijimin e kushteve për punësimin e personave me hendikep dhe për adaptimin e vendit të punës, bjen në barë të Fondit të posaçëm për sigurimin e kushteve për punësimin dhe punën e personave invalidor (në tekstin e mëtutjeshëm: Fondi i veçantë).

Personi

me hendikep i cili kryen pamvarsisht profesion ose veprimtari ka të drejtë të shfrytëzojë kompenzim nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni

7

Personi

i punësuar me hendikep me shiqim të dëmtuar, me ndëgjim të dëmtuar, personi i hendikepuar trupor, personi me pengesë në zhvillimin psikik, personi me pengesa të kombinuara dhe personi me psikosa të cilit për shkak të llojit dhe shkallës së pengimit i është caktuar nevojë specifike gjatë punës lirohet prej pagimit të tatimit personal nga të ardhurat.

Mjetet

pë kontribut për sigurim penzionalo invalidor, kontribut për sigurim shëndetësor dhe kontribut për punësimin e personave nga paragrafi 1 i këtij neni i siguron Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Neni

8

Nën

përkrahje financiare në punësim në kuptim të këtij ligji llogariten privilegjet të cilat i fiton personi me hendikep i cili pamvarur kryen profesion ose veprimtari gjegjësisht shoqata tregtare gjetë shfrytëzimit të mjeteve nga Fondi i veçantë.

Neni

9

Përshkak

të punësimit të personit me hendikep formohen shoqata mbrojtëse si shoqata tregtare. Shoqata mbrojtëse mund të themelohet nëse punëson së paku 5 (pesë) persona nga të cilët së paku 40% janë persona të hendikepuar nga numri i përgjithshëm i të punësuarve, prej të cilëve së paku gjysma duhet të jenë persona me shiqim të dëmtuar, ndëgjim të dëmtuar, persona me hendikep trupor, person me pengesa të lehta në zhvillimin psikik, person me pengesa të kombinuara dhe personi

---

me psikoza i cili për shkak shkallës së invaliditetit ka nevoja specifike gjatë punësimit dhe në punë.

Shoqata mbrojtëse nëse nuk i plotëson kushtet të caktuara nga paragrafi 1 i këtij neni e humbë statutin e shoqatës tregtare.

Neni

10

Të

punësuarit në shoqatë tregtare të cilët nuk janë persona me hendikep lirohen nga pagimi i tatimit personal të të ardhurave dhe për to sigurohen mjete për kontribut për sigurim penzional dhe invalidor nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Shoqatat

mbrojtëse lirohen nga pagimi i tatimit nga fitimi dhe të gjitha të dhënat nga fitimi.

Neni

11

Për

shkak të realizimit të qëllimeve dhe detyrave të përbashkëta në përmirësimin e punësimit të personit me hendikep në shoqatat mbrojtëse, këto shoqata themelojnë Bashkësi të shoqatave mbrojtëse (në tekstin e mëtutjeshëm: Bashkësia), si bashkësi e interesit ekonomik në pajtueshmëri me Ligjin për shoqata tregtare.

Bashkësia

nga paragrafi 1 i këtij neni është e obligura rregullisht ti mbledhë dhe ndjekë të dhënat për mjetet e paguara nga ana e shoqatave mbrojtëse në pajtueshmëri me nenet 15 dhe 17 alinea 1 e këtij ligji.

- AFTËSIM

PUNE ME PUNËSIM

Neni

12

Aftësim

pune me punësim në kuptim të këtij ligji është aftësimi i personave me hendikep për punë praktike për

punë të caktuara në pajtueshmëri me nevojat e punëdhënësit dhe personit me hendikep.

Punëdhënësi

e udhëzon personin e punësuar me hendikep në aftësim pune nëse ai nuk është i aftësuar për kryerjen e punëve gjegjëse.

Personin

e papunësuar me hendikep në aftësim pune e udhëzon Enti për punësim i Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtutjeshëm: Enti).

Enti,

gjegjësisht punëdhënësi i cili e udhëzon personin me hendikep në aftësim pune me punëdhënësin lidh kontratë me të cilën rregullohen kushtet nën të cilat do të zbatohet aftësimi i punës, zgjatja e aftësimin, verifikimi i aftësisë, mjetet për aftësim pune dhe të drejtat dhe obligimet reciproke.

Neni

13

Mjetet

e duhura për aftësim pune nga neni 12 i këtij ligji sigurohen nga Fondi i veçantë.

Neni

14

Personi

me hendikep i cili udhëzohet në aftësim pune nuk ka statut të personit të punësuar te punëdhënësi tek i cili profesionalisht aftësohet, përveç nëse nuk është i punësuar tek ai.

- FONDI

I VEÇANTË PËR SIGURIMIN E KUSHTEVE PËR

PUNËSIM DHE PUNË

TË PERSONAVE ME HENDIKEP

Neni

15

Përshkak

të finansimit të punëve për krijimin e kushteve të veçanta për punësim dhe punë të personave me hendikep, adaptimi i vendit të punës dhe furnizim të pajisjes, instrumente, aparate, pjesë rezervë dhe vegla 15% nga mjetet e realizuara të përgjithshme nga kontributi i përhershëm për punësim ndahen në nënllogarinë e Entit (Fond i veçantë) më së voni deri më 30 të muajt për muajt e kaluar.

Enti

është i obliguar mjetet e ndara nga Fondi i veçantë që ti shfrytëzojë ekskluzivisht për qëllimet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni.

Enti

me shfrytëzuesin e mjeteve lidhë kontratë për shfrytëzimin e mjeteve.

Neni

16

Personi

me hendikep i cili individualisht kryen profesion ose veprimtari, shoqata mbrojtëse dhe person tjetër juridik i cili punëson person me hendikep dorëzon kërkesë për ndarje të mjeteve nga Fondi i veçantë deri te Këshilli drejtues i Entit.

Këshilli

drejtues i Entit sjellë vendim për ndarje të mjeteve nga Fondi i veçantë në secilën 60 ditë.

Kundër

vendimit të Këshillit drejtues të Entit për ndarjen e mjeteve nga Fondi i veçantë mund të paraqitet ankesë deri te Ministria për punë dhe politikë sociale në afat prej 8 ditësh nga dita e fitimit të vendimit.

Gjatë

ndarjes së mjeteve nga Fondi i veçantë niset nga vëllimi dhe lloji i kushteve të veçanta për punësim dhe adaptim të vendeve të punës të cilat duhet të krijohen, lloji dhe vëllimi i pajisjes, instrumentet, aparatet, veglat dhe pjesët rezervë të cilat duhet të sigurohen përshkak të krijimit të kushteve të veçanta për punësimin dhe punën e personit me hendikep.

Ministria

e punës dhe politikës sociale më afër i përshkruan kriteret nga paragrafi 4 i këtij neni dhe mënyrën e ndarjes së mjeteve për sigurimin e kushteve për punësimin dhe punën e personave me hendikep.

Neni

17

Metet

në Fondin e veçantë sigurohen nga:

- tatimi

i vlerës së shtuar dhe doganat e paguara nga shoqatat mbrojtëse në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë të cilat në tërësi të nënlogarisë së Fondit të veçantë referohen më së voni deri më 15 të muajt të kaluar;

- dhurata,

legatet (pasuritë) dhe

- burime

tjera.

Neni

18

Enti

është i obliguar në secilin gjashtë mujor të

---

dorëzohë raport deri te Ministria për punë dhe politikë sociale për mjetet e realizuara në të gjitha bazat dhe për realizimin e mjeteve të përgjithshme në Fondin e veçantë nga nenet 15 paragrafi 1 dhe neni 17 i këtij ligji, si dhe për shpërndarjen e mjeteve nga Fondi i veçantë në pajtueshmëri me këtë ligj.

- MBIKQYRJE

Neni  
19

Mbikqyrje  
mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji kryen Ministria për punë dhe politikë sociale.

Mbikqyrje  
inspektuese mbi zbatimin e dispozitave nga ky ligj i cili i përket kushteve të veçanta për punësim dhe punë të personave me hendikep kryen inspektoriati Republikan për punë.

- DISPOZITAT  
NDËSHKUESE

Neni  
20

Me  
dënim në të holla prej 10.000 deri më 300.000 denarë do të dënohet për kundërvajtje shoqata mbrojtëse nëse nuk i plotëson kushtet nga neni 9 i këtij ligji.

Me  
dënim në të holla prej 1.000 deri më 50.000 denarë do të dënohet për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni edhe personi përgjegjës në shoqatën mbrojtëse.

Neni  
21

Me  
dënim në të holla prej 10.000 deri më 300.000

denarë do të dënohet për kundërvajtje  
personi juridik nëse nuk i plotëson kushtet nga neni 5 i  
këtij ligji.

Me dënim në të holla  
prej 1.000 deri më 50.000 denarë do të dënohet  
për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni edhe  
personi përgjegjës në personin juridik.

Neni  
22  
Me  
dënim në të holla prej 10.000 deri më 300.000  
denarë do të dënohet për kundërvajtje  
personi me hendikep i cili pamvarsisht kryen profesion ose veprimtari  
nëse mjetet e fituara nga Fondi i veçantë nuk i  
shfrytëzon në pajtueshmëri me nenin 6 të këtij  
ligji.

Neni  
23  
Me  
dënim në të holla prej 1.000 deri më 50.000  
denarë do të dënohet për kundërvajtje  
personi me hendikep i cili pamvarsisht kryen profesion ose veprimtari  
nëse mjetet e fituara nga Fondi i veçantë nuk i  
shfrytëzon në pajtueshmëri me nenin 6 të  
këtij ligji.

Neni  
24  
Me dënim në të holla  
prej 1.000 deri më 50.000 denarë do të dënohet  
për kundërvajtje personi përgjegjës në  
Entin, për shpërndarjen të mjeteve në kundërshtim  
me nenin 16 paragrafët 2 dhe 4 të këtij ligji.

#### - DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni  
25  
Në  
afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij  
ligji, ndërmarjen ekzistuese për punësim të  
personave me hendikep janë të detyruar që ta  
harmonizojnë punën e tyre dhe të organizohen në  
shoqata mbrojtëse në pajtueshmëri me këtë  
ligj dhe Ligjin për shoqata tregtare.  
Nëse  
në afat nga paragrafi 1 i këtij neni ndërmarjen  
ekzistuese për punësimin e personave me hendikep nuk

---

harmonizohen me dispozitat nga ky ligj, pushojnë së punuari si ndërmarrje për punësimin e personave me hendikep.

Neni  
26  
Ministria  
e punës dhe politikës sociale në afat prej 60 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji do ta sjellë dispozitën nga neni 16 paragrafi 5 i këtij ligji.

Neni  
27  
Ky  
ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

LIGJ

PËR  
NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN  
E  
LIGJIT PËR PUNËSIMIN E

PERSONAVE  
ME HENDIKEP  
(“Gazeta  
zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 16/2004)

Neni  
1  
Në  
ligjin për punësim të personave me hendikep (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 16/2004), në nenin 1 pas fjalës “kryejnë” fjalët “profesion ose” shlyhen, kurse pas fjalës “veprimtari” fraza shlyhet dhe shtohen fjalët “si tregtar individ”, në reshtin e gjashtë pas fjalës “persona” shtohen fjalët: “- shoqatë tregtare”.

Neni

2

Neni

2 ndryshohet dhe thot:

“Person

me hendikep në kuptim të këtij ligji, është personi me dëmtim të të pamurit, dëmtim ndëgjimi, me pengesa në zë, të folurit dhe gjuhën, person me hendikep trupor, person me të meta të lehta në zhvillimin psikik, person me të meta të kombinuara dhe person me psikoza i cili përshkak shkallës së invaliditetit ka nevoja specifike në punë”.

Invaliditetin

në bazë të kërkesës së dorëzuar

nga personi me hendikep e përcakton komisioni për vlerësim

të aftësisë punuese i Fondit të sigurimit

penzionalo invalidor i Republikës së Maqedonisë (në

tekstin e mëtutjeshëm: Fondi), përveç se

hendikepi i personit nuk është vërtetuar nga organ

tjetër kompetent”.

Neni

3

Në

nenin 4 paragrafi 1 alinea 1 fjalët “dhe adaptimi i vendit të

punës” zëvendësohen me fjalët: “me adaptim të

vendit të punës në të cilën do të

punojë personi me hendikep nëse është e

nevojshme, furnizim i pajisjes, mbindërtim dhe adaptim i

hapsirës punuese sipas kriterëve dhe mënyrës të

caktuar me akt të ministrit për punë dhe politikë

sociale”.

Neni

4

Pas

nenit 4 shtohet nen i ri 4-a, i cili thot:

Neni

4-a

“Punëdhënësi

nuk mund të punësojë ose të shpërndajë

nga një vend pune në tjetër person me hendikep i cili

për atë vend pune nuk i përmbush kushtet e

përgjithshme dhe të veçanta, gjegjësisht i cili

nuk është i aftësuar për kryerjen e punëve

në atë vend pune.

Personi

me hendikep të cilit i është marrë aftësia

afariste nuk mundet të jetë punëdhënësi ose

të kryejë punë te personi përgjegjës te

punëdhënësi”.

Neni

5

Në

nenin 5 para paragrafit 1 shtohet paragraf i ri 1, i cili thot:

“Punëdhënësi

para se të fillojë të kryejë veprimtari prej organeve kompetente duhet të kërkojë vendim se lokalet punuese dhe ndihmëse dhe pajisja i plotësojnë kushtet minimalo teknike dhe masat e parashikuara, normat dhe standartet për kryerjen e veprimtarisë gjegjëse”.

Paragrafi

1 bëhet paragraf 2.

Neni

6

Neni

6 ndryshohet dhe thot:

“Mjetet

për krijimin e kushteve të veçanta dhe privilegjeve për punësimin dhe punën e personave me hendikep me adaptim të vendit të punës, furnizimin e pajisjes, mbindërtim dhe adaptim të hapsirës punuese, sikurohen nga Fondi i veçantë për sigurimin e kushteve për punësimin dhe punën e personave me hendikep (në tekstin e mëtutjeshëm: Fondi i veçantë)”.

Neni

7

Në

nenin 7 paragrafi 1 fjalët “me dëmtim të të pamurit, dëmtim ndëgjimi, person me hendikep trupor, person me të meta të lehta në zhvillimin psikik, person me të meta të kombinuara dhe person me psikoza i cili përshkak shkallës së invaliditetit ju është vërtetuar nevoja specifike gjatë punës” zëvendësohet me fjalët: “tek i cili është vërtetuar invaliditeti në kuptim të nenit 2 paragrafi 1 i këtij ligji”.

Neni

8

Në

nenin 8 pas fjalëve “profesion ose” shlyhen, ndërsa pas fjalës “veprimtari” fraza shlyhet dhe shtohen fjalët “si tregtar individ”.

Neni

9

Në

nenin 9 paragrafi 1 fjalët “me dëmtim të të pamurit, dëmtim ndëgjimi, person me hendikep trupor, person me të meta të lehta në zhvillimin psikik, person me të meta të kombinuara dhe person me psikoza i cili përshkak shkallës së invaliditetit ju është vërtetuar nevoja specifike gjatë punës” zëvendësohet me fjalët “është vërtetuar hendikep në kuptim të nenit 2 paragrafi 1 i këtij ligji”.

Neni

10

Neni

12 zëvendësohet dhe thot:

“Aftësim

pune në kuptim të këtij ligji, është aftësimi i personit me hendikep për punë praktike për punë të caktuara në pajtueshmëri me nevojat e punëdhënësit dhe personit me hendikep.

Personin e papunësuar me hendikep

në aftësim pune përshkak punësimit te punëdhënësi e udhëzon Enti për punësim i Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtutjeshëm”: Enti).

Personi

i punësuar me hendikep, i cili nuk është i aftësuar për kryerjen e punëve të caktuara, në aftësim pune e udhëzon punëdhënësi. Aftësim i punës mund të kryhet te punëdhënësi ose te punëdhënësit tjetër sipas programeve të veçanta, nën kushte dhe mënyrë të vërtetuara me akt të Ligjit”.

Neni

11

Pas

nenit 12 shtohet nen i ri 12-a, i cili thot:

Neni

12-a

Punësimi

i personit me hendikep kryhet në radhën e personave të hendikepuar të evidentuar pa punë në Entin.

Personi

me hendikep mundet të punësohet në vend të punës ose të caktohet në vend tjetër të punës nëse i plotëson kushtet e përgjithshme dhe të veçanta dhe është i aftësuar për kryerjen e punëve në atë vend pune”.

Neni

12

Në

nenin 15 paragrafi 1 pas fjalës “pajisje” fjalët “instrumente, aparate, pjesë rezervë dhe vegla” zëvendësohen me fjalët: “mbindërtim dhe adaptim e hapsirës punuese”.

Pas

paragrafit 1 shtohet paragraf 2, i cili thot:

“Për

kryerjen e funksioneve të Fondit të veçantë gjatë një viti kalendarik nuk mund të harxhohen më së shumti 2% nga mjetet e përgjithshme me të cilat disponon Fondi i veçantë”.

Paragrafi

2 bëhet paragraf 3, ndërsa paragrafi 3 bëhet paragraf

4.

Neni

14

Në

nenin 16 paragrafi 1 ndryshohet dhe thot:

“Personi

me hendikep i cili pamvarur kryen veprimtari si tregtar individ, shoqata mbrojtëse dhe person tjetër juridik, dorëzon kërkesë për ndarjen e mjeteve nga Fondi i veçantë nga Këshili drejtues i Entit”.

Në

paragrafin 4 pas fjalës „pajisje“ fjalët „instrumente, aparate dhe pjesë rezervë“ zëvendësohen me fjalët „mbindërtim dhe adaptim i hapsirës punuese mvarësisht nga procesi tekniko-teknologjik“.

Në

nenin 16 paragrafi 5 shlyhet.

Neni

15

Pas

nenit 16 shtohen dy nene të reja 16-a dhe 16-b, të cilat thonë:

“Neni

16-a

Mjetet

nga Fondi i veçantë ndahen si të pakthyera për:

- punësimin

e personit me hendikep në kohë të pacaktuar në lartësi prej 20 rroga mesatare të paguara në Republikën e Maqedonisë për muajn e kaluar para punësimit, gjegjësisht 30 rroga mesatare të paguara në Reopublikën e Maqedonisë për muajn e kaluar para punësimit për punësimin e person të verbër me dëmtim të pamurit mbi 97% dhe person me hendikep trupor me dëmtim trupor mbi 90%.

- Adaptim

i vendit të punës në lartësi prej 30 rrogave mesatare të paguara në Republikën e Maqedonisë për muajn e kaluar para dorëzimit të kërkesës dhe të njejtat mundet përsëri të shfrytëzohen nëse këtë e detyrojnë ndryshimet e procesit tekniko-teknologjik ose lloji dhe shkalla e hendikepit të personit me hendikep;

- Furnizim

i pajisjes në lartësi deri më 50 rroga mesatare të paguara në Republikën e Maqedonisë për muajn e kaluar para dorëzimit të kërkesës, në pajtueshmëri me numrin e të punësuarve të ri persona të hendikepuar dhe kriteriumet e caktuara me aktin nga

neni 3 i këtij ligji.

- Mbindërtimi  
dhe adaptimi i hapsirës punuese mvarësisht nga procesi  
tekniko-teknologjik në lartësi deri më 50 rroga  
mesatare të paguara në

Republikën e Maqedonisë për  
muajn e kaluar para dorëzimit të kërkesës, në  
pajtueshmëri me numrin e të punësuarve të ri  
persona të hendikepuar dhe kriteriumet e caktuara me aktin nga  
neni 3 i këtij ligji.

Mjetet nga paragrafi 1 pikat 3 dhe 4  
të këtij neni nuk mundet përsëri të  
shfrytëzohen para kalimit të tre viteve nga mjetet e  
lejuara paraprake prej Fondit të veçantë.

Dorëzuesi

i kërkesës mund të shfrytëzojë mjete të  
këtij neni nën kushtet e caktuara në Ligjin, nëse  
veprimtarisht është aktiv, ka bonitet pozitiv të dhënë  
nga institucioni kompetent dhe rregullisht paguan rrogë dhe  
paguan tatime dhe kontribute nga rroga për nëntë muajt  
e fundit llogaritur nga dita punësimit të personit me  
hendikep.

Punëdhënësi është

i obliguar të punësuarit ti paguajë rrogë në  
pajtueshmëri me ligjin dhe kontratën kolektive, bashkë  
me rrogën të llogaritë dhe paguajë kontribute të  
caktuara dhe tatim të rrogës, ndërsa rrogën t'ja  
paguajë nëpërmjet llogarisë rrjedhëse ose  
librezë kursimi.

Mjetet

nga paragrafi 1 pika 2, 3 dhe 4 të këtij neni mund të  
shfrytëzohen ekskluzivisht për qëllimet për të  
cilat janë ndarë.

Mënyra e pagesës të

mjeteve të ndara punëdhënësit nga Fondi i veçantë  
bëhet në mënyrë të caktuar me aktin nga neni  
3 i këtij ligji".

Neni 16-b

Nëse

personit të punësuar me hendikep për të cilin  
janë shfrytëzuar mjetet i pushon marëdhënja e  
punës sipas cilës do bazë ose punëdhënësi  
e zvogëlon numrin e personave të përgjithshëm me  
hendikep në kohë të pacaktuar, i njejtë është  
i obliguar në afat prej 8 ditësh nga dita e ndodhjes së  
ndryshimit ta lajmërojë Entin.

Nëse

personit me hendikep për të cilin shfrytëzohen mjetet  
i pushon marëdhënja e punës para skadimit të  
afatit prej 3 vitesh nga dita e punësimit, përveç  
pas fuqisë së ligjit ose në rast vdekje, shfrytëzuesi  
i mjeteve është i detyruar në afat prej tre muajsh për  
vendin e tij të punësojë tjetër person me

hendiklep pa të drejtë përsëri të shfrytëzojë mjete për punësim të personit me hendikep.

Punëdhënësi

nuk mund të shfrytëzojë mjete nga Fondi i veçantë për punësimin e personit të pa punësuar me hendikep për të cilin më janë shfrytëzuar mjetet për punësim, para skadimit të tre viteve llogaritur nga dita e pushimit të marëdhënjes së punës në kohë të pacaktuar.

Personit të hendikepuar të cilit marëdhënja e punës i ka pushuar jo nga faji i tij dhe për të cilin punëdhënësi i ka kthyer mjetet në Fondin e veçantë për punësimin e tij përsëri mund të shfrytëzohen edhe para skadimit të afatit nga paragrafi 3 i këtij neni.

Shfrytëzuesi

i mjeteve për punësim të personit me hendikep i cili nuk do të punësojë person tjetër me hendikep në vend të personit me hendikep të cilit i ka pushuar marëdhënja e punës, në kuptim të paragrafit 2 të këtij neni, ose këso të drejte ka realizuar në bazë të të dhënave të pa sakta, është i obliguar që mjetet ti kthejë Fondit të veçantë në afat prej 30 ditësh nga dita e verifikimit të gjendjes në vlerë të plotë të rritura me kamatë bankare të mjeteve pas parashiqimit.

Nëse

punëdhënësi e zvogëlon numrin e përgjithshëm të personave të punësuar me hendikep në kohë të pacaktuar nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ndërsa në vendin e tij pranon persona të ri me hendikep, nuk mund të shfrytëzojë mjete për të pranuarit e ri persona me hendikep.

Shfrytëzuesit e mjeteve nga Fondi

i veçantë pajisjen e furnizuar nuk mund ta huazojnë, ta japin me qira ose ta tjetërsojnë në afat prej tre vitesh nga dita e fitimit të mjeteve.

Shfrytëzuesi

i mjeteve nga Fondi i veçantë lokalit e mbindërtuar të punës ose të adaptuar nuk mundet ta huazojë, ta japë me qira ose ta tjetërsojë në afat prej pesë vitesh nga dita e fitimit të mjeteve”.

Neni

16

Në nenin 18 para paragrafit 1 shtohet paragraf i ri 1, i cili thot:

“Enti

bën ekspertizë në shfrytëzimin qëllimor të mjeteve në pajtueshmëri me këtë ligj”.

Paragrafi

1 bëhet paragraf 2.

Neni

17

Në

nenin 19 paragrafi 2 pas fjalës “kryen” fjala “Republikane”

---

zëvendësohet me fjalën “Shtetëror”.

Neni

18

Pas

nenit 20 shtohet nen i ri 20-a, i cili thot:

“Neni

20-a

Me

dënim në të holla prej 10.000 deri më 300.000

denarë do të dënohet për kundërvajtje

personi juridik nëse vepron kundrejt dispozitës nga neni

4-a dhe neni 16-b paragrafët 1, 7 dhe 8 të këtij

ligji.

Me

dënim në të holla prej 1.000 deri më 50.000

denarë do të dënohet për kundërvajtje nga

paragrafi 1 i këtij neni edhe personi përgjegjës në

personin juridik”.

Neni

19

Në

nenin 23 pas fjalës “kryen” fjalët “profesion ose”

shlyhen, kurse pas fjalës “veprimtari” shtohen fjalët

“si tregtar-individ”.

Neni

20

Pas

nenit 25 shtohet nen i ri 25-a, i cili thot:

“Neni

15-a

Në

afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij

ligji kryerësit e pamvarur ekzistues të profesionit ose

veprimtarisë, janë të obliguar ta harmonizojnë

punën e tyre në pajtueshmëri me këtë ligj

dhe Ligjin për shoqata tregtare”.

Neni

21

Ministria

për punë dhe politikë sociale në afat prej 60

ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji

do ta sjellë aktin e nenit 3 të këtij ligji.

---

Neni

22

Kërkesat

e shtruara për shpërndarjen e mjeteve nga Fondi i veçantë të cilat nuk janë zgjidhur deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të zgjidhen sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni

23

Ky

ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".





# LIGJI PËR PUNËSIMIN E

## PERSONAVE ME HENDIKEP

(Tekst i pastruar i përpiluar nga  
Bashkësia e shoqatave mbrojtëse)

### - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni  
1

Me këtë ligj rregullohen kushtet e veçanta për punësimin dhe punën e personit të hendikepuar: kur pamvarësisht kryejë veprimtari si tregtar individ, te punëdhënësi ose ka vetinë e punëdhënësit, si dhe kushtet për themelimin dhe privilegjet për punën e shoqatës tregtare për punësimin e personave me hendikep (në tekstin e mëtutjeshëm: shoqatë mbrojtëse).

Neni  
2

Person me hendikep në kuptim të këtij ligji, është personi me dëmtim të pamurit, dëmtim në ndëgjim, me pengesa në zë, të folurit dhe gjuhën, personi i hendikepuar trupor, person me të meta të lehta në zhvillimin psikik, person me të meta të kombinuara dhe person me psikoza i cili për shkak shkallës së hendikepi ka nevojë specifike në punësim.

Hendikepin në bazë të kërkesës së shtruar nga personi me hendikep e vërteton komisioni për vlerësim të aftësisë punuese i Fondit për sigurim pensional dhe invalidor i Maqedonisë (në tekstin e mëtutjeshëm: Fondi), përveç se nëse hendikepi i personit nuk është vërtetuar nga organ tjetër kompetent.

Neni  
3

Personave me hendikep dhe shoqatave mbrojtëse ju zbatohen kontrata ndërkombëtare të ratifikuara në pajtueshmëri me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë.

- KUSHTE  
TË VEÇANTA DHE PRIVILEGJE PËR PUNËSIM DHE PUNË  
TË PERSONAVE ME HENDIKEP

Neni  
4

Kushte të veçanta dhe privilegje për punësimin dhe punën e personit me hendikep janë:

- krijimi i kushteve për punë dhe adaptim të vendeve të punës në të cilin do të punojë personi me hendikep nëse është e nevojshme, furnizimi i pajisjes, mbindërtimi dhe adaptimi i hapsirës punuese sipas kriteriumeve dhe mënyrës të vërtetuar me akt të ministrit për punë dhe politikë sociale;
- lirimi nga tatimet dhe sigurimi i mjeteve për kontribute dhe
- përkrahje financiare për punësimin.

Neni 4-a

Punëdhënësi nuk mundet të punësojë ose të ndrojë prej një në tjetër vend pune personin me hendikep i cili për atë vend pune nuk i plotëson kushte e përgjithshme dhe të veçanta gjegjësisht i cili nuk është i aftësuar për kryerjen e punëve në atë vend pune.

Personit me hendikep të cilit i është marrë aftësia vepruese nuk mundet të jetë punëdhënës ose të kryejë punë të personit përgjegjës tek punëdhënësi.

Neni  
5

Punëdhënësi para se të fillojë të kryejë veprimtari, prej organit kompetent duhet të fitojë vendim se hapsirat punuese dhe ndihmëse dhe pajisja i përmbushin kushtet minimalo-teknike dhe masat e parapara, nomativat dhe standartet për kryerjen e veprimtarisë gjegjëse.

Gjatë punësimit të personit me hendikep, punëdhënësi është i obliguar të krijojë kushte për punë dhe adaptim të vendit të punës mvarësisht nga

---

vendi i punës, lloji dhe shkalla e arsimimit dhe lloji dhe shkalla e hendikepit i personit me hendikep i cili punësohet.

Neni

6

Mjetet

për krijimin e kushteve dhe privilegjeve për punësimin dhe punën e personave me hendikep me adaptim të vendeve të punës, furnizim i pajisjes, mbindërtimi dhe adaptimi i hapsirës punuese, sigurohen nga Fondi i veçantë për sigurimin e kushteve për punësim dhe punë të personave me hendikep (në tekstin e mëtutjeshëm: Fond i veçantë).

Neni

7

Personi

i punësuar me hendikep tek i cili është vërtetuar hendikepi në kuptim të nenit 2 paragrafi 1 i këtij ligji lirohen nga pagimi i tatimit personal nga të ardhurat.

Mjetet

për kontribut për sigurim penzionalo invalidor, kontribut për sigurim shëndetësor dhe kontribut për punësimin e personave nga paragrafi 1 i këtij neni sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Neni

8

Nën

përkrahje financiare në punësim në kuptim të këtij ligji llogariten privilegjet të cilat i fiton personi me hendikep i cili pamvarur kryen veprimtari si tregtar individ, gjegjësisht shoqata tregtare gjetë shfrytëzimit të mjeteve nga Fondi i veçantë.

Neni

9

Përshkak

të punësimit të personit me hendikep formohen shoqata mbrojtëse si shoqata tregtare. Shoqata mbrojtëse mund të themelohet nëse punëson së paku 5 (pesë) persona nga të cilët së paku 40% janë persona të hendikepuar nga numri i përgjithshëm i të punësuarve, prej të cilëve së paku gjysma janë persona me hendikep të vërtetuar në kuptim të nenit 2 paragrafi 1 i këtij ligji.

Shoqata mbrojtëse nëse nuk i plotëson kushtet të caktuara nga paragrafi 1 i këtij neni e humbë statutin e shoqatës tregtare.

Neni

10

Të

punësuarit në shoqatë mbrojtëse të cilët nuk janë persona me hendikep lirohen nga pagimi i tatimit personal të të ardhurave dhe për to sigurohen mjete për kontribut për sigurim penzional dhe invalidor nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Shoqatat

mbrojtëse lirohen nga pagimi i tatimit nga fitimi dhe të gjitha të dhënat nga fitimi.

Neni

11

Për

shkak të realizimit të qëllimeve dhe detyrave të përbashkëta në përmirësimin e punësimit të personit me hendikep në shoqatat mbrojtëse, këto shoqata themelojnë Bashkësi të shoqatave mbrojtëse (në tekstin e mëtutjeshëm: Bashkësia), si bashkësi e interesit ekonomik në pajtueshmëri me Ligjin për shoqata tregtare.

Bashkësia

nga paragrafi 1 i këtij neni është e obligura rregullisht ti mbledhë dhe ndjekë të dhënat për mjetet e paguara nga ana e shoqatave mbrojtëse në pajtueshmëri me ligjin për shoqata tregtare.

Bashkësia

nga paragrafi 1 i këtij neni është e obligura rregullisht ti mbledhë dhe ndjekë të dhënat për mjetet e paguara nga ana e shoqatave mbrojtëse në pajtueshmëri me nenet 15 dhe 17 alinea 1 e këtij ligji.

- AFTËSIM

PUNE ME PUNËSIM

Neni

12

Aftësim

pune me punësim në kuptim të këtij ligji është aftësimi i personit me hendikep për punë praktike për punë të caktuara në pajtueshmëri me nevojat e punëdhënësit dhe personit me hendikep.

Personin

e papunësuar me hendikep në aftësim pune përshkak të punësimit të punëdhënësi e udhëzon Enti për punësim i Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtutjeshëm: Enti).

Personi

i punësuar me hendikep, i cili nuk është aftësuar për kryerjen e punëve përkatëse, në aftësim pune e udhëzon punëdhënësi.

Aftësimi

i punës mund të bëhet të punëdhënësi

---

ose te punëdhënës tjetër sipas programeve të veçanta, nën kushte dhe mënyrë të caktuara me akt nga Enti.

Neni

12-a

Punësimi

i personit me hendikep kryhet nga radha e personave të papunësuar me hendikep të evidentuar në Ent.

Personi

me hendikep mundet të punësohet në vend pune për të cilën ka arsimim për punën përkatëse, gjegjësisht mundet të punësohet ose të ndrohet në vend tjetër pune nëse i përmbush kushtet e përgjithshme dhe të veçanta ose është aftësuar për kryerjen e punëve në atë vend pune.

Neni

13

Mjetet

e duhura për punën e Komisionit nga neni 2 paragrafi 2 i këtij ligji dhe për aftësim pune nga neni 12 i këtij ligji sigurohen nga Fondi i veçantë.

Neni

14

Personi

me hendikep i cili udhëzohet në aftësim pune nuk ka statut të personit të punësuar te punëdhënësi tek i cili profesionalisht aftësohet, përveç nëse nuk është i punësuar tek ai.

- FONDI

I VEÇANTË PËR SIGURIMIN E KUSHTEVE PËR

PUNËSIM DHE PUNË  
TË PERSONAVE ME HENDIKEP

Neni

15

Përshkak

të finansimit të punëve për krijimin e kushteve të veçanta për punësim dhe punë të personave me hendikep, adaptimi i vendit të punës dhe furnizim të pajisjes, mbindërtimi dhe adaptimi i hapsirës punuese 15% nga mjetet e realizuara të përgjithshme nga kontributi i përhershëm për punësim ndahen në nënllogarinë e Entit (Fond i veçantë) më së voni deri më 30 të muajt për muajt e kaluar.

Për

kryerjen e funksioneve të Fondit të veçantë

gjatë një viti kalendarik mund të harxhohen më së shumti 2% nga mjetet e përgjithshme me të cilat disponon Fondi i veçantë.

Enti është i obliguar mjetet e ndara nga Fondi i veçantë që ti shfrytëzojë ekskluzivisht për qëllimet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni.

Enti me shfrytëzuesin e mjeteve lidhë kontratë për shfrytëzimin e mjeteve.

Neni

16

Personi

me hendikep i cili individualisht kryen veprimtari si tregtar individ, shoqata mbrojtëse dhe person tjetër juridik i cili punëson person me hendikep dorëzon kërkesë për ndarje të mjeteve nga Fondi i veçantë deri te Këshilli drejtues i Entit.

Këshilli

drejtues i Entit sjellë vendim për ndarje të mjeteve nga Fondi i veçantë në secilën 60 ditë.

Kundër

vendimit të Këshillit drejtues të Entit për ndarjen e mjeteve nga Fondi i veçantë mund të paraqitet ankesë deri te Ministria për punë dhe politikë sociale në afat prej 8 ditësh nga dita e fitimit të vendimit.

Gjatë

ndarjes së mjeteve nga Fondi i veçantë niset nga vëllimi dhe lloji i kushteve të veçanta për punësim dhe adaptim të vendeve të punës të cilat duhet të krijohen, lloji dhe vëllimi i pajisjes, mbindërtimi dhe adaptimi i hapsirës punuese mvarësisht nga procesi tekniko teknologjik të cilat duhen të sigurohen përshkak të krijimit të kushteve të veçanta për punësimin dhe punën e personit me hendikep.

Neni

16-a

Mjetet

nga Fondi i veçantë ndahen si të pakthyera për:

- punësimin

e personit me hendikep në kohë të pacaktuar në lartësi prej 20 rroga mesatare të paguara në Republikën e Maqedonisë për muajn e kaluar para punësimit, gjegjësisht 30 rroga mesatare të paguara në Reopublikën e Maqedonisë për muajn e kaluar para punësimit për punësimin e person të verbër me dëmtim të pamurit mbi 97% dhe person me hendikep trupor me dëmtim trupor mbi 90%.

- Adaptim

i vendit të punës në lartësi prej 30 rrogave mesatare të paguara në Republikën e Maqedonisë për muajn e kaluar para dorëzimit të kërkesës dhe të njejtat mundet përsëri të shfrytëzohen nëse këtë e detyrojnë ndryshimet e procesit tekniko-teknologjik ose lloji dhe shkalla e hendikepit të personit me hendikep;

- Furnizim

i pajisjes në lartësi deri më 50 rroga mesatare të paguara në Republikën e Maqedonisë për muajn e kaluar para dorëzimit të kërkesës, në pajtueshmëri me numrin e të punësuarve të ri persona të hendikepuar dhe kriteriumet e caktuara me aktin nga neni 3 i këtij ligji.

- Mbindërtimi dhe adaptimi i hapsirës punuese mvarësisht nga procesi tekniko-teknologjik në lartësi deri më 50 rroga mesatare të paguara në Republikën e Maqedonisë për muajn e kaluar para dorëzimit të kërkesës, në pajtueshmëri me numrin e të punësuarve të ri persona të hendikepuar dhe kriteriumet e caktuara me aktin nga neni 3 i këtij ligji.

Mjetet nga paragrafi 1 pikat 1, 3 dhe 4 të këtij neni nuk mundet përsëri të shfrytëzohen para kalimit të tre viteve nga mjetet e lejuara paraprake prej Fondit të veçantë.

Dorëzuesi i kërkesës mund të shfrytëzojë mjete nga Fondi i veçantë për qëllimet nga paragrafi 1 pikat 1, 3 dhe 4 të këtij neni nën kushtet e caktuara në Ligjin, nëse veprimtarisht është aktiv, ka bonitet pozitiv të dhënë nga institucioni kompetent dhe rregullisht paguan rrogë dhe paguan tatime dhe kontribute nga rroga për nëntë muajt e fundit llogaritur nga dita punësimit të personit me hendikep.

Punëdhënësi është i obliguar të punësuarit ti paguajë rrogë në pajtueshmëri me ligjin dhe kontratën kolektive, bashkë me rrogën të llogaritë dhe paguajë kontribute të caktuara dhe tatim të rrogës, ndërsa rrogën t'ja paguajë nëpërmjet llogarisë rrjedhëse ose librezë kursimi.

Mjetet nga paragrafi 1 pika 2, 3 dhe 4 të këtij neni mund të shfrytëzohen ekskluzivisht për qëllimet për të cilat janë ndarë.

Mënyra e pagesës të mjeteve të ndara punëdhënësit nga Fondi i veçantë bëhet në mënyrë të caktuar me aktin nga neni 3 i këtij ligji”.

#### Neni 16-b

Nëse personit të punësuar me hendikep për të cilin janë shfrytëzuar mjetet i pushon marëdhënja e punës sipas cilës do bazë ose punëdhënësi e zvogëlon numrin e personave të përgjithshëm me hendikep në kohë të pacaktuar, i njejtë është i obliguar në afat prej 8 ditësh nga dita e ndodhjes së ndryshimit ta lajmërojë Entin.  
Nëse personit me hendikep për të cilin shfrytëzohen mjetet

i pushon marëdhënja e punës para skadimit të afatit prej 3 vitesh nga dita e punësimit, përveç pas fuqisë së ligjit ose në rast vdekje, shfrytëzuesi i mjeteve është i detyruar në afat prej tre muajsh për vendin e tij të punësojë tjetër person me hendikep pa të drejtë përsëri të shfrytëzojë mjete për punësim të personit me hendikep.

Punëdhënësi nuk mund të shfrytëzojë mjete nga Fondi i veçantë për punësimin e personit të pa punësuar me hendikep për të cilin më janë shfrytëzuar mjetet për punësim, para skadimit të tre viteve llogaritur nga dita e pushimit të marëdhënjes së punës në kohë të pacaktuar.

Personit të hendikepuar të cilit marëdhënja e punës i ka pushuar jo nga faji i tij dhe për të cilin punëdhënësi i ka kthyer mjetet në Fondin e veçantë, mjetet për punësimin e tij përsëri mund të shfrytëzohen edhe para skadimit të afatit nga paragrafi 3 i këtij neni. Shfrytëzuesi

i mjeteve për punësim të personit me hendikep i cili nuk do të punësojë person tjetër me hendikep në vend të personit me hendikep të cilit i ka pushuar marëdhënja e punës, në kuptim të paragrafit 2 të këtij neni, ose këso të drejte ka realizuar në bazë të të dhënave të pa sakta, është i obliguar që mjetet ti kthejë Fondit të veçantë në afat prej 30 ditësh nga dita e verifikimit të gjendjes në vlerë të plotë të rritura me kamatë bankare të mjeteve pas parashiqimit.

Nëse punëdhënësi e zvogëlon numrin e përgjithshëm të personave të punësuar me hendikep në kohë të pacaktuar nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ndërsa në vendin e tij pranon persona të ri me hendikep, nuk mund të shfrytëzojë mjete për të pranuarit e ri persona me hendikep.

Shfrytëzuesit e mjeteve nga Fondi i veçantë pajisjen e furnizuar nuk mund ta huazojnë, ta japin me qira ose ta tjetërsojnë në afat prej tre vitesh nga dita e fitimit të mjeteve.

Shfrytëzuesi i mjeteve nga Fondi i veçantë lokalit e mbindërtuar të punës ose të adaptuar nuk mundet ta huazojë, ta japë me qira ose ta tjetërsojë në afat prej pesë vitesh nga dita e fitimit të mjeteve”.

Neni

17

Metet

në Fondin e veçantë sigurohen nga:

- tatimi

i vlerës së shtuar dhe doganat e paguara nga shoqatat mbrojtëse në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë të cilat në tërësi të nënlogarisë së Fondit të veçantë referohen më së voni deri më 15 të muajt të kaluar;

---

- dhurata,  
legatet (pasuritë) dhe

- burime  
tjera.

Neni

18

Enti

bën ekspertizë në shfrytëzimin qëllimor të mjeteve në pajtueshmëri me këtë ligj.

Enti

është i obliguar në secilin gjashtë mujor të dorëzojë raport deri te Ministria për punë dhe politikë sociale për mjetet e realizuara në të gjitha bazat dhe për realizimin e mjeteve të përgjithshme në Fondin e veçantë nga nenet 15 paragrafi 1 dhe neni 17 i këtij ligji, si dhe për shpërndarjen e mjeteve nga Fondi i veçantë në pajtueshmëri me këtë ligj.

- MBIKQYRJE

Neni

19

Mbikqyrje

mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji kryen Ministria për punë dhe politikë sociale.

Mbikqyrje

inspektuese mbi zbatimin e dispozitave nga ky ligj i cili i përket kushteve të veçanta për punësim dhe punë të personave me hendikep kryen inspektoriati Shtetror për punë.

- DISPOZITAT  
NDËSHKUESE

Neni

20

Me

dënim në të holla prej 10.000 deri më 300.000 denarë do të dënohet për kundërvajtje shoqata mbrojtëse nëse nuk i plotëson kushtet nga neni

---

9 i këtij ligji.

Me  
dënim në të holla prej 1.000 deri më 50.000  
denarë do të dënohet për kundërvajtje nga  
paragrafi 1 i këtij neni edhe personi përgjegjës në  
shoqatën mbrojtëse.

Neni  
20-a

Me dënim në të holla  
prej 10.000 deri më 300.000 denarë do të dënohet  
për kundërvajtje personi juridik nëse vepron kundrejt  
dispozitës nga neni 4-a dhe neni 16-b paragrafët 1, 7 dhe 8  
të këtij ligji.

Me  
dënim në të holla prej 1.000 deri më 50.000  
denarë do të dënohet për kundërvajtje nga  
paragrafi 1 i këtij neni edhe personi përgjegjës në  
personin juridik”.

Neni  
21

Me  
dënim në të holla prej 10.000 deri më 300.000  
denarë do të dënohet për kundërvajtje  
personi juridik nëse nuk i plotëson kushtet nga neni 5 i  
këtij ligji.

Me dënim në të holla  
prej 1.000 deri më 50.000 denarë do të dënohet  
për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni edhe  
personi përgjegjës në personin juridik.

Neni  
22

Me  
dënim në të holla prej 10.000 deri më 300.000  
denarë do të dënohet për kundërvajtje  
punëdhënësi nëse mjetet e fituara nga Fondi i  
veçantë nuk i shfrytëzon në pajtueshmëri  
me nenin 6 të këtij ligji.

Neni  
23

Me  
dënim në të holla prej 1.000 deri më 50.000  
denarë do të dënohet për kundërvajtje  
personi me hendikep i cili pamvarsisht kryen veprimtari si tregtar  
individ nëse mjetet e fituara nga Fondi i veçantë  
nuk i shfrytëzon në pajtueshmëri me nenin 6 të  
këtij ligji.

Neni  
24

---

Me dënim në të holla  
prej 1.000 deri më 50.000 denarë do të dënohet  
për kundërvajtje personi përgjegjës në  
Entin, për shpërndarjen të mjeteve në kundërshtim  
me nenin 16 paragrafët 2 dhe 4 të këtij ligji.

- DISPOZITAT  
KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni

25

Në

afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij  
ligji, ndërmarjen ekzistuese për punësim të  
personave me hendikep janë të detyruar që ta  
harmonizojnë punën e tyre dhe të organizohen në  
shoqata mbrojtëse në pajtueshmëri me këtë  
ligj dhe Ligjin për shoqata tregtare.

Nëse

në afat nga paragrafi 1 i këtij neni ndërmarjet  
ekzistuese për punësimin e personave me hendikep nuk  
harmonizohen me dispozitat nga ky ligj, pushojnë së punuari  
si ndërmarje për punësimin e personave me hendikep.

Neni

25-a

Në afat prej tre muajsh nga dita  
e hyrjes në fuqi të këtij ligji kryerësit e  
pamvarur ekzistues të profesionit ose veprimtarisë, janë  
të obliguar ta harmonizojnë punën e tyre në  
pajtueshmëri me këtë ligj dhe Ligjin për shoqata  
tregtare.

---

Neni  
26  
Ministri  
për punë dhe politikë sociale në afat prej 60  
ditësh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji do ta  
sjellë aktin nga neni 3 i këtij ligji.

Neni  
27  
Kërkesat  
e shtruara për ndarjen e mjeteve nga Fondi i veçantë  
të cilat nuk janë zgjidhur deri në ditën e hyrjes  
në fuqi të këtij ligji do të zgjidhen sipas  
dispozitave të këtij ligji.

Neni  
28  
Ky  
ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në  
“Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.

---

Në  
bazë të nenit 4 të Ligjit për punësim të  
personave me hendikep ("Gazetë zyrtare e RM" nr.44/2000,  
16/2004), ministri për punë dhe politikë sociale  
solli:

RREGULLORE  
PËR  
KRITERIUMET DHE MËNYRËN E NDARJES SË

MJETEVE  
NGA FONDI I VEÇANTË PËR SIGURIMIN E  
KUSHTEVE  
PËR PUNËSIM DHE PUNË TË  
PERSONAVE  
ME HENDIKEP  
(„Gazetë  
zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 24/2004)

Neni

1

Me  
këtë Rregullore përcaktohen kriteriumet, mënyra e  
ndarjes dhe pagimi i mjeteve të punëdhënësit nga  
Fondi i veçantë për sigurimin e kushteve për  
punësimin dhe punën e personave me hendikep (në  
tekstin e mëtuftjeshëm: Fondi i veçantë).

Neni

2

Mjetet  
nga Fondi i veçantë ndahen për:

- punësimin  
e personit me hendikep për kohë të pacaktuar;

- adaptim

---

të vendit të punës ku do të punësohet  
personi me hendikep;

- furnizimi

i pajisjes së duhur për punësimin dhe punën e  
personit me hendikep;

- mbindërtim

dhe adaptim i hapsirës punuese për punësimin dhe  
punën e personit me hendikep.

Personit juridik i

cili nuk është shoqatë mbrojtëse, mund ti ndahen  
mjete nga Fondi i veçantë:

- për

punësim të personit me hendikep në kohë të  
pacaktuar dhe adaptim të vendit të punës në të  
cilin do të punojë personi me hendikep të cilit iu  
janë vërtetuar nevojat specifike gjatë punësimit  
dhe punës.

Shoqatës mbrojtëse mund ti

ndahen mjete nga Fondi i veçantë për:

- punësimin

e personit me hendikep në kohë të pacaktuar;

- adaptim

të vendit të punës në të cilin do të  
punojë personi me hendikep;

- furnizim

i pajisjes së duhur për punësim dhe punë të  
personit me hendikep, dhe

- mbindërtim

dhe adaptim i hapsirës punuese për punësimin dhe  
punën e personit me hendikep.

Personit invalidor

i cili pamvarur kryen veprimtari si tregtar individ mund ti ndahen  
mjete nga Fondi i veçantë për:

- punësimin

e personit me hendikep për kohë të pacaktuar;

- adaptim

të vendit të punës në të cilin do të  
punojë personi me hendikep të cilit i janë vërtetuar  
nevojat specifike gjatë punësimit dhe punës; dhe

- furnizim

i pajisjes e duhur për punësim dhe punë të  
personit me hendikep.

neni

3

Shpërndarja

e mjeteve nga Fondi i veçantë kryhet në bazë të kërkesës së shtruar për ndarjen e mjeteve nga Fondi i veçantë.

Kërkesa

dorëzohet deri te Këshilli drejtues i Entit për punësim i Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtuftjeshëm: Enti), nëpërmjet byrosë për punësim në teritorin e së cilës është selia e punëdhënësit.

Neni

4

Me

kërkesën për shpërndarje të mjeteve nga Fondi i veçantë, shtrohen këto dokumente, të duhura për secilin nga baza për shpërndarje të mjeteve nga neni 2, paragrafi 1 i kësaj Rregullore:

- formular

kërkesë e plotësuar për ndarjen e mjeteve nga Fondi i veçantë që e jep Enti;

- vendimin

nga regjistri gjyqësor i punëdhënësit nga gjyqi regjistror kompetent me të gjitha shtojcat-fotokopje;

- vendim

nga Enti Shtetror për statistikë- formular P-1 ose P-3:

- vendim

për plotësimin e masave, normativave dhe standarteve për mbrojtje nga puna nga Inspektoriati shtetror për punë;

- vendim

për plotësimin e kushteve për kryerjen e veprimtarive të caktuara me ligj nga inspektori Shtetror sanitar dhe shëndetësor; dhe

- vendim

për plotësimin e kushteve minimalo-teknike për kryerjen e veprimtarive të caktuara me ligj nga Ministria e ekonomisë;

- bonitet

i dhënë nga Regjistri qendror;

- vërtetim

se kundër punëdhënësit nuk është ngritur procedura për falementim të dhënë nga Gjyqi kompetent komunal;

- vërtetim

nga Bashkësia e shoqatave mbrojtëse në Maqedoni për përmbushjen e kushteve nga neni 9 i Ligjit për punësimin e personave me hendikep;

- parallogari

mujore për rrogën e paguar, tatimi personal i rrogës  
i llogaritur dhe paguar për 9 muajt e fundit, në  
pajtueshmëri me ligj, para dorëzimit të kërkesës  
– formular PDP-MP;

- çertifikata,  
urdhesa dhe listë me numra të llogarive rrjedhëse ose  
librezave kursyese të verifikuar nga banka deponent i së  
cilës është punëdhënësi për  
rrogat e paguara për 9 muajt e fundit për personat e  
hendikepuar me hendikep;

- rrogat  
e paguara të punëtorëve për punë me kohë  
pune të plotë mos të jetë më e ulët se  
rroga më e ulët e përcaktuar për shkallë të  
caktuara të ndërlikueshmërisë sipas ligjit ose  
kontratës kolektive.

Neni

5

Nën

punësim të personit me hendikep në kuptim të  
kësaj rregulloreje përshkak të ndarjes së mjeteve  
nga Fondi i veçantë llogaritet punësimi në kohë  
të pacaktuar i personit invalidor nga neni 2 paragrafi 1 dhe  
neni 4-a nga Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit  
për punësim të personave me hendikep.

Neni

6

Nën

punësim në kuptim të kësaj rregullore nuk  
llogaritet:

- kur  
punëdhënësi e zvogëlon numrin e përgjithshëm  
të personave të punësuar me hendikep në kohë  
të pacaktuar llogaritur nga dita e hyrjes në fuqi të  
Ligjit për punësim të personave me hendikep, ndërsa  
në vend të tyre punëson persona të tjerë me  
hendikep;

- kur  
punëdhënësi punëson person me hendikep për  
të cilin janë shfrytëzuar mjetet nga Fondi i veçantë  
tre vitet e fundit para punësimit.

Neni

7

Punëdhënësi

i cili punëson person me hendikep në kohë të  
pacaktuar kërkesës për ndarje të mjeteve nga  
Fondi i veçantë, përskaj dokumenteve nga neni 4 i  
kësaj rregullore, ia bashkangjet edhe këto dokumente:

- listë  
të personave me hendikep për të cilët kërkohet  
ndarja e mjeteve me mbiemër, emër dhe numri i vetëm  
amë i qytetarit; dhe

- dokument  
për kryerjen e arsimit, gjegjësisht vërtetim për  
aftësi pune;

- ekzemplar  
nga kontrata e lidhur dhe verifikuar për punë me personim  
me hendikep në kohë të pacaktuar.

Neni

8

Punëdhënësi

krijon kushte përkatëse për punë me adaptim të  
vendit të punës mvarësisht nga vendi i punës,  
llojin dhe shkallën e arsimit dhe llojin dhe shkallën e  
invaliditetit të personit me hendikep i cili punësohet.

Adaptimi

i vendit të punës në kuptim të kësaj  
rregullore përfshinë:

- përshtatja  
e pajisjes, mjeteve për punë, aparatet dhe mjetet tjera  
teknike për punë me instalimin e aparateve mekanike,  
elektrike, elektronike, të zëshme, ndritshme dhe të  
ngjajshme me të cilët mundësohet punë e sigurtë,  
e papenguar dhe produktive të një ose më shumë  
personave me hendikep;

- përshtatja  
e hapsirave punuese dhe ndihmës me vëndosjen ose ndërtimin  
e dhiareve të kalueshme, rrethore të pjerta, mbrojtëse  
dhe të ngjajshme, me çka personave me hendikep iu  
mundësohet akses i papenguar dhe i sigurtë deri dhe prej  
vendit të punës.

Me

nevojën e përcaktuar të adaptimit të vendit të  
punës punëdhënësi përpilon dokumentacion  
përkatës me përshkrim të asaj se çka do të  
adaptohet dhe mënyra në të cilën do të  
adaptohet, me dokumentacion të shoqëruar teknik.

Nëse adaptimi i vendit të  
punës te i njëjti punëdhënësi është në  
funksion të më shumë personave me hendikep, nuk do të  
ndahen mjete për secilin person veçmas.

Neni

9

Kërkesës

për ndarje të mjeteve nga Fondi i veçantë për  
adaptim të vendit të punës përkaj dokumenteve  
nga neni 4 i kësaj Rregullore, i bashkangjiten edhe këto  
dokumente:

- listë e personave të punësuar me hendikep për të cilët do të kryhet adaptimi i vendit të punës me mbiemër, emër dhe numër të vetëm amë të qytetarit;
- dokumentacion me përshkrim të asaj çka do të adaptohet dhe mënyrës në të cilën do të adaptohet, me dokumentacion shoqërues teknik;
- tre oferta me çmime për mjetet e nevojshme, specifikim dhe afat të shënuar për kryerjen e adaptimit të vendit të punës.

Neni

10

Furnizimi

për pajisje për punësim të personit me hendikep në kuptim të kësaj rregullore përfshinë furnizim të planifikuar të pajisjes për veprimtari prodhuese dhe shërbyese, kompjuterë dhe teknika kompjuterike, makina për prodhimtari të prodhimeve të ndryshme, viza prodhuese, maquina për shartim, formë ose paketim, vegla dhe kallëf si tërësi teknologjike për formën ose prodhimin e formave të ndryshme ose prodhimeve, aparate transportuese lidhur me procesin e prodhimit ose forma të ngjajshme të mjeteve për punë si maquina të vetme ose pjesë përbërëse të tërësisë gjegjëse nga viza e caktuar teknologjike.

Për

furnizim të pajisjes nga paragrafi 1 i këtij neni nga Fondi i veçantë për punësimin e personit me hendikep ndahen mjete të pakthyeshme dhe atë:

- deri më dy persona me hendikep – 30 rroga mesatare;
- prej tre deri më pesë persona me hendikep- 40 rroga mesatare; dhe
- mbi pesë persona me hendikep – 50 rroga mesatare.

Neni

11

Kërkesës

për ndarje të mjeteve nga Fondi i veçantë për furnizim të pajisjes përkaj dokumenteve nga neni 4 i kësaj rregullore, i bashkangjiten edhe këto dokumente:

- tre oferta me çmim, kushtet e shitjes, afati i dërgimit të

pajisjes me përkthim në gjuhën maqedone nëse furnizuesi është nga jashtë;

- dokumentacioni me përshkrim të karakteristikave tekniko-teknologjike dhe prodhuese që duhet të furnizohen, emri-firma e prodhuesit me katalog gjegjësisht vizatime shoqëruese, shema ose skica të pajisjes me përkthim në gjuhën maqedone nëse teksti është në gjuhën e huaj dhe

- skicë e hapsirës punuese ku do të jetë e vendosur pajisja.

Neni

12

Mbindërtimi dhe adaptimi i hapsirës punuese për punësimin e personit me hendikep në kuptim të kësaj rregullore përfshinë mbindërtim të planifikuar të hapsirave punuese dhe adaptim të hapsirës punuese në të cilën do të punojë personi me hendikep.

Për mbindërtim dhe adaptim të hapsirës punuese nga paragrafi 1 i këtij neni nga Fondi i veçantë shpërndahen mjete të pakthyera dhe atë:

- deri më dy persona me hendikep – 30 rroga mesatare;

- prej tre deri më pesë persona me hendikep- 40 rroga mesatare; dhe

- mbi pesë persona me hendikep – 50 rroga mesatare.

Neni

13

Kërkesës për ndarje të mjeteve nga Fondi i veçantë për mbindërtim dhe adaptim të hapsirës punuese përkaj dokumenteve nga neni 4 i kësaj rregullore, i bashkangjiten edhe këto dokumente:

- leje për ndërtim të dhënë nga organi kompetent shtetror për objektin që do të ndërtohet ose adaptohet;

- dokumentacion teknik me përshkrim të punëve që duhet të kryhen;

- tre oferta me çmime, specifikacion dhe afat të shënuar për kryerjen e punëve për mbindërtim dhe adaptim të hapsirës punuese; dhe

- skicë  
e hapsirës punuese që duhet të adaptohet dhe  
instalacionet që duhet të kryhen, llogariten ose  
rindërtohen.

Neni

14

Shpërndarja  
e mjeteve për adaptimin e vendit të punës, furnizim i  
pajisjes dhe mbindërtim dhe adaptim të planifikuar të  
hapsirës punuese, furnizim i pajisjes dhe mbindërtim dhe  
adaptim i hapsirës punuese për të cilët  
shpërndahet.

Mjetet  
e shpërndara nga Fondi i veçantë emërohen në  
xhiro llogari të punëdhënësit, në afat prej  
8 ditësh llogaritur nga dita e nënshkrimit të  
kontratës për ndarjen e mjeteve.

Punëdhënësi  
në afat prej 60 ditësh nga dita e emërimit të  
mjeteve e kryen adaptacionin e lejuar të hapsirës punuese  
për pagesën e kryer për qëllimin për të  
cilin ndahen mjetet, me shkrim e lajmëron Entin.

Neni

15

Kërkuesi  
i mjeteve nga Fondi i veçantë për furnizim të  
pajisjes dhe për mbindërtim dhe planifikim të  
adaptimit të hapsirës punuese të cilat kërkesa për  
ndarjen e mjeteve nga Fondi i veçantë iu ka zgjidhur  
negativisht dhe nuk i janë ndarë mjete, mundet përsëri  
të dorëzojë kërkesë për ndarjen e  
mjeteve pas skadimit të një viti llogaritur nga dita e  
refuzimit të kërkesës.

Neni

16

Enti  
dhe byroja për punësim, në kryerjen e ekspertizës  
së drejtpërdrejtë të kërkuesi i mjeteve,  
bashkpunon me organet kompetente shetërore, Inspektoratin shtetëror për  
punë dhe subjekte të tjerë, ndërsa në  
funksion të përpilimit të tërësishëm të  
kërkesave të shtruara për ndarjen e mjeteve si dhe  
rrjedhën e realizimit të tyre të shfrytëzuesit e  
mjeteve të shpërndara.

Kërkesat  
e pakompletuara nuk do të pranohen dhe ndaj tyre nuk do të  
vendoset deri sa nuk mënjanojnë mungesat, në pajtueshmëri  
me treguesit e Entit.

Enti  
me shfrytëzuesin e mjeteve lidh kontratë për  
shfrytëzimin e mjeteve me të cilën më afër  
përcaktohen kushtet dhe mënyra e përdorimit të  
mjeteve.

---

Neni

17

Gjatë

shqyrtimit të kërkesave të shtruara për shpërndarjen e mjeteve nga Fondi i veçantë në mbledhjet e Këshillit drejtues të Entit mund të ftohet dhe përfaqësojë edhe nga një përfaqësues nga Bashkësia e shoqatave mbrojtëse të Maqedonisë dhe Bashkësia e organizatave të personave me hendikep në Maqedoni.

Neni

18

Me

ditën e hyrjes në fuqi të kësaj rregullore, pushon së vlejuri Rregullorja për kriteriumet dhe mënyrën e shpërndarjes së mjeteve nga Fondi i veçantë për sigurimin e kushteve për punësim dhe punë të personave me hendikep ("Gazetë zyrtare e RM" nr. 70/2000 dhe 92/2001).

Neni

19

Kjo

rregullore hyn në fuqi ditën e ardhshme nga dita e hyrjes në fuqi në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Nr.

08-1305/5      Ministër

26

maj 2004      Jovan Manasievski, v.d

Shkup



---

Në  
bazë të nenit 12 nga Ligji për punësim të  
personit me hendikep ("Gazetë zyrtare e RM" nr.44/2000 dhe  
16/2004) dhe neni 90 paragrafi 1 alinea 1 nga Ligji për punësim  
dhe sigurim në rast të papunësisë ("Gazetë  
zyrtare e RM" nr. 37/97, 25/2000, 101/2000, 50/2001, 25/2003 dhe  
37/2004), Këshilli drejtues i Agjencionit për punësim  
të Republikës së Maqedonisë, në mbledhjen e  
mbajtur me datë 05.08.2004, solli:

RREGULLORE  
PËR  
AFTËSIM PUNE  
TË  
PERSONAVE ME HENDIKEP  
("Gazetë  
zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 54/2004)

Neni

1

Me

këtë rregullore rregullohen: mënyra dhe kushtet për aftësim pune të personit të papunësuar me hendikep përshkak të punësimit dhe aftësimin të punës të personit të punësuar me hendikep për punë praktike për punë të caktuara në pajtueshmëri me nevojat e punëdhënësit dhe personit me hendikep; të drejtat dhe obligimet e punëdhënësit dhe të papunësuarit gjegjësisht personit të punësuar me hendikep; zgjedhja e personit të papunësuar me hendikep për aftësim pune; verifikim i aftësisë punuese të personit me hendikep; evidentim për aftësim pune dhe pyetje të tjera me domethënje për aftësim pune.

Neni

2

Aftësi

pune në kuptim të kësaj rregullore, është aftësimi i personit me hendikep për punë praktike për punë të caktuara në pajtueshmëri me nevojat e punëdhënësit dhe personit me hendikep.

Neni

3

Personi

me hendikep i cili dërgohet në aftësim pune është personi me dëmtim të të pamurit, dëmtim në ndëgjim, me pengesa në zë, të folurit dhe gjuhën, personi i hendikepuar trupor, person me të meta të lehta në zhvillimin psikik, person me të meta të kombinuara dhe person me psikoza i cili për shkak shkallës së hendikepi ka nevojë specifike në punësim.

Personi

me hendikep dërgohet në aftësim pune nëse nuk ka arsimim për punën ose veprimtarin përkatëse të cilën do ta ushtrojë, gjegjësisht nuk është i aftësuar për kryerjen e punëve në vendin e punës për të cilin punëdhënësi ka teguar nevojë.

Neni

4

Në

aftësim pune dërgohet personi me hendikep i cili me Programë për aftësim pune do të aftësohet për punë të së paku shkallës së I ose II të përgaditjes profesionale.

Neni

5

Personin

e papunësuar me hendikep në aftësim pune përshkak punësimit tek punëdhënësi e udhëzon Agjencioni për punësim i Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtutjeshëm: Agjencioni), ndërsa pas saj nuk është i aftësuar për kryerjen e

punëve te vendi i punës për të cilën punëdhënësi ka treguar nevojë.

Personin e punësuar me hendikep i cili nuk është i aftësuar për kryerjen e punëve te vendi i punës për të cilën punëdhënësi ka treguar nevojë.

Personi i papunësuar dhe i punësuar me hendikep para se të udhëzohet në aftësim pune, Qendra për punësim e udhëzon deri te Komisioni për vlerësim të aftësisë punuese të Fondit për sigurim penzionalo invalidor të Maqedonisë përshkak fitimit të konstatimit, vlerësimit dhe mendimit për aftësim pune për vendin e punës për të cilin do të aftësohet.

Në vlerësim të aftësisë punuese personi me hendikep udhëzohet edhe kur personi me hendikep nuk udhëzohet në aftësim pune, deri sa për kryerjen e punëve në vendin e punës nuk është e nevojshme përgaditje profesionale e përcaktuar me nenin 4 të kësaj rregullore

Aftësimi i punës i personit me hendikep mund të bëhet te punëdhënësi i cili ka treguar nevojë për aftësim pune ose te punëdhënësi tjetër.

Neni

6

Aftësim pune i personit të papunësuar me hendikep kryhet në bazë të kërkesës së shtruar për aftësim pune të personit me hendikep nga punëdhënësi deri te Qendra për punësim në regjionin e të cilit është selia e punëdhënësit, gjegjësisht vendi ku e kryen veprimtarinë, deri sa në Qendër për punësim nuk është evidentuar person i papunësuar me hendikep të cilët janë të aftësuar për punë praktike në vendin e punës për të cilin është treguar nevojë nga punëdhënësi.

Aftësim pune i personit të punësuar me hendikep kryet në bazë të kërkesës së shtruar për aftësim pune të personit me hendikep dorëzuar nga punëdhënësi deri te Qendra për punësim në regjionin e të cilit gjindet selia e punëdhënësit, gjegjësisht vendi ku e kryen veprimtarinë.

Neni

7

Kërkesës në bazë të neni 6 të kësaj rregullore i bashkangjiten këto dokumente:

- Plotësim i formularit Kërkesë të cilën e jep Agjencioni;

- Plotësim i formularit Mendim nga Qendra për punësim;

- Listë

e personave me hendikep për të cilët kërkohet aftësim pune, me mbiemër, emër dhe numër të vetëm amë të qytetarit;

- Konstatim,

vlerësim, dhe mendim të dhënë nga Komisioni për vlerësimin e aftësisë punuese të Fondit për sigurim penzionalo invalidor të Maqedonisë;

- Programë

për zbatimin e aftësisë punuese;

- Vendimin

nga regjistri gjyqësor i punëdhënësit nga gjyqi regjistror kompetent me të gjitha shtojcat;

- Vendim

nga Enti Shtetror për statistikë- formular P-1 ose P-3:

- Vendim

për plotësimin e masave, normativave dhe standarteve për mbrojtje nga puna nga Inspektorati shtetror për punë;

- Vendim

për plotësimin e kushteve për kryerjen e veprimtarive të caktuara me ligj nga inspektori Shtetror sanitar dhe shëndetësor;

- Vendim

për plotësimin e kushteve minimalo-teknike për kryerjen e veprimtarive të caktuara me ligj nga Ministria e ekonomisë;

- Raport

me mendim për bonitet nga Regjistri qendror me vlefshmëri në ditën e dorëzimit të kërkesës;  
(shoqatat që janë të reja të themeluara, gjegjësisht janë veprimtarisht aktive më pak se një vit dhe tregtar-individ, është e nevojshme të dorëzojë Lajmërim nga Regjistri qendror);

- vërtetim

se kundër punëdhënësit nuk është ngritur procedura për falementim të dhënë nga Gjyqi kompetent;

- Dëshmi

për pagesën e rregullt të rrogave dhe kontributeve nga rroga dhe tatim personal për tre muajt e fundit për të gjithë personat e punësuar;

- Formular

PDD-MP;

- Listë

me numrat e llogarive rrjedhëse ose librezave të kursimit të verifikuar nga banka deponues i të cilit është punëdhënësi;

- Urdhëresë

PP-30 dhe urdhëresë PP-50;

- Çertifikatë

nga banka.

Shoqatat e themeluara të reja dhe tregtarët individ të cilët veprimtarisht nuk janë aktiv nuk dorëzojnë dokumente për pagesë të rregullt të rrogës dhe kontributeve nga rroga dhe tatimi personal për 3 muajt e fundit për të gjithë personat e punësuar.

Neni 8

Aftësim

pune kryhet në bazë të Programës, të përpiluar nga punëdhënësi në bashkëpunim me Qendrën për punësim.

Programi duhet të përmbajë pjesë teorike dhe praktike. Pjesa praktike e programit me njohjen e Ligjit për punësim të personave me hendikep, të drejtat themelore nga marrëdhënja e punës (Ligji për marrëdhënie pune dhe Kontrata kolektive), Ligji për mbrojtje gjatë punës dhe Ligji për mbrojtje nga zjarret dhe eksplozivet zbatohet nga ana e Qendrës për punësim, në korniza të Klubit punues.

Pjesa teorike nga Programi, për karakteristikat tekniko teknologjike të procesit prodhues, shërbimeve dhe punëve tjera lidhur me veprimtarinë e punëdhënësit zbatohen te punëdhënësi.

Pjesa praktike përfshinë:

- Njohje me pajisjen dhe mjetet për punë të cilat do ti shfrytëzojë personi me hendikep në dhe rreth procesit të prodhimit, gjegjësisht dhënie të shërbimeve;

- Puna praktike

Raporti i fondit të orëve të përcaktuara për pjesën teorike dhe praktike përcaktohet në bazë e vlerësimit të llojit dhe ndërlikimit të detyrave punuese për vendin e punës për të cilin kryhet aftësim pune, lloji dhe shkalla e hendikepit dhe shkalla e arsimimit të personit me hendikep.

Pjesa praktike duhet të arrijë më së shumti 80 përqind nga fondi i përgjithshëm i orëve.

Neni

9

Gjatë

njoftimit me karakteristikat tekniko teknologjike të procesit prodhues, shërbimet dhe punët tjera të lidhura me veprimtarinë e punëdhënësit dhe me pjesën praktike të Programit, personi-trajnuar e nevojshme është të jetë profesionalist në veprimtarinë për të cilën personat me hendikep aftësohen profesionalisht dhe poashtu duhet të kenë së paku të kryer shkallën e IV-1 të përgaditjes profesionale.

Në propozim të punëdhënësit për nevojat e të cilit bëhet aftësim pune Qendra për punësim jep mendim për kalfifikimin e personit-trajner.

Neni

10

Pjesa

teorike dhe praktike nga Programi për aftësim pune, nuk mund të kryhet jashtë kohës së punës dhe në periudhë ndërmjet orëve 22 dhe 6.

Neni

11

Kohëzgjatja

për aftësim pune përcaktohet në bazë të vlersimit të llojit dhe rëndësisë të detyrave punuese në vendin e punës për të cilin aftësohet personi me hendikep, si dhe lloji dhe shkalla e hendikepit të personit i cili do të aftësohet, i përcaktuar nga organi kompetent.

Kohëzgjatja

e aftësisë punuese nuk mund të jetë më e shkurtër se një muaj as më e gjatë se tre muaj.

Neni

12

Qendra

për punësim pas kërkesës së shtruar për aftësim pune kryen ekspertizë tek punëdhënësi i cili ka treguar nevojë për aftësim pune të personit me hendikep, gjegjësisht te punëdhënësi tjetër ku do të bëhet aftësim pune.

Në

bazë të ekspertizës së kryer, Qendra për punësim përpilon dhe dorëzon Mendim deri te Agjencioni.

Këshilli

drejtues i Agjencionit vendos për ndarje të mjeteve nga Fondi i veçantë për realizimin e Programës për aftësim pune me sjellje të Vendimit.

Pas

sjelljes së Vendimit nga Këshilli drejtues i Agjencionit, Qendra për punësim i ka filluar aktivitetet për realizimin e aftësisë punuese.

Neni

13

---

Për kryerjen e aftësisë punuese të personit me hendikep, në bazë të Vendimit të Këshillit drejtues lidhet Kontratë në mes Qendrës për punësim dhe punëdhënësit i cili ka treguar nevojë për aftësim pune.

Nëse aftësia punuese kryhet te punëdhënësi tjetër, lidhet Kontratë në mes Qendrës për punësim, punëdhënësit për nevojën e të cilit kryhet aftësia punuese dhe punëdhënësit tek i cili aftësia punuese do të kryhet.

Neni

14

Me

kontratën e nenit 13 veçmas regullohet:

- përshkrimi i aftësisë punuese;

- kushtet nën të cilat kryhet aftësia punuese;

- numri i personave me hendikep të cilët do të aftësohen për punë;

- kohëzgjatja e aftësisë punuese;

- ku do të kryhet aftësia punuese;

- personat (trajnuet) të cilët do ta zbatojnë aftësinë

- harxhimet për realizimin e aftësisë punuese;

- themelimi i mardhënjes së punës në kohë të pacaktuar me aftësi pune të personit me hendikep; dhe

- të drejta dhe obligime tjera reciproke.

Neni

15

Punëdhënësi

kërkesa e të cilit për ndarjen e mjeteve nga Fondi i veçantë për aftësim pune është zgjidhur negativisht, nuk ka të drejtë të parashtrojë kërkesë për aftësim pune të personit me hendikep para skadimit të një viti nga dita e refuzimit të kërkesës.

Neni

16

Qendra

për punësim lidhë Kontratë me të cilën personi me hendikep është inkuadruar në Programin për aftësim pune, me të cilën për së afërmi rregullohen të drejtat dhe obligimet e aftësisë punuese.

Neni

17

Mjetet

që ndahen për aftësim pune të personave të papunësuar me hendikep kushtojnë:

- për secilin person të papunësuar me hendikep, ndihma në të holla në shumë mujore prej 5.000 denarë;
- për realizimin e Programit për aftësim pune te punëdhënësi, si kompensim i harxhimeve për grupë prej:
  - 1-5 persona, mjete në shumë mujore prej 10.000 denarë;
  - 6-10 persona, mjete në shumë mujore prej 20.000 denarë;
  - Mbi 10 persona, mjete në shumë mujore prej 30.000 denarë.

Mjetet të

cilat ndahen për aftësim pune të personi të punësuar me hendikep, kushtojnë:

- për secilin person të punësuar me hendikep, ndihma në të holla në shumë mujore prej 3.000 denarë;
- për realizimin e Programit për aftësim pune te punëdhënësi, si kompensim i harxhimeve për grupë prej:
  - 1-5 persona, mjete në shumë mujore prej 8.000 denarë;
  - 6-10 persona, mjete në shumë mujore prej 16.000 denarë;
  - Mbi 10 persona, mjete në shumë mujore prej 24.000 denarë;

Mjetet

nga paragrafi 1 alinea 1 dhe nga paragrafi 2 alinea 1 nga ky nen,

Qendra për punësim, në bazë të kontratës, i paguan në xhiro llogari të punëdhënësit për nevojat e të cilit bëhet aftësia punuese i personave me hendikep, gjegjësisht te punëdhënësi te i cili aftësia punuese do të kryhet.

## Neni 18

Gjatë aftësisë punuese mbahet evidencë nga ana e punëdhënësit për rregullsinë e personit me hendikep i cili aftësohet për punë.  
Punëdhënësi është i obliguar deri te Qendra për punësim në muaj të parashtrorë njoftim për rregullsinë e secilit person me hendikep i cili aftësohet për punë.

## Neni 19

Aftësia punuese e personit me hendikep pas përfundimit të aftësisë punuese e përcakton Komisioni i përbërë prej dy përfaqësuesve të punëdhënësit për nevojat e të cilit kryhet aftësia punuese dhe një përfaqësues nga Qendra për punësim.

Aftësia punuese e personit me hendikep i cili pamvarësisht do të kryejë veprimtari si tregtar-individ, për veprimtari për të cilën nuk ka arsim për punën përkatëse, e përcakton Komisioni të cilin e formon Qendra për punësim.

Personi me hendikep i cili me sukses e ka kryer aftësinë punuese, fiton vërtetim nga Qendra për punësim, i cili përmban të dhëna kryesore për personin me hendikep, kohëzgjatja e aftësisë punuese dhe punët dhe detyrat e punës për të cilat është aftësuar për punë.

## Neni 20

Aftësia punuese e personit me hendikep i cili është punësuar para hyres në fuqi të kësaj rregullore, dhe më është përvetësuar me njohuri dhe skadhtësi të nevojshme për kryerjen e detyrave të punës nga vendi i punës në të cilën është caktuar, e vërteton Komisioni nga paragrafi 1 i nenit 19, në bazë të kërkesës së shtruar të punëdhënësit deri te Qendra për punësim, dhe Konstatim, vlerësim dhe mendim nga Komisioni i Fondit për sigurim penzionalo invalidor i Maqedonisë.

Aftësia punuese e personit me hendikep nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet në bazë të programit të shkurtuar, që e përpilon punëdhënësi në bashkëpunim me Qendrën për punësim dhe kohëzgjatja e të njejtës nuk mund të jetë më e gjatë se një muaj.

Programi i shkurtuar i përfshinë të gjitha elementet nga neni 8

i kësaj rregullore.

Mjetet për realizimin e Programit të shkurtuar për aftësim pune për personin e punësuar me hendikep janë në lartësi të përcaktuar në nenin 17 paragrafi 2 alinea 1 nga kjo rregullore, ndërsa mjetet për realizimin e Programit për aftësi punuese të punëdhënësi janë në lartësi prej 50% nga mjetet për këtë qëllim të përcaktuara me nenin 17 paragrafi 2 alinea 2 e kësaj rregullore.

Neni 21

Punëdhënësi me personin e papunësuar me hendikep i cili është aftësuar për punë është i obliguar të themelojë marrëdhënie pune për kohë të pacaktuar menjëherë, por më së voni 8 ditë pas përfundimit të aftësisë punuese.

Nëse punëdhënësi nga shkaqe të pa arsyeshme e ndërprent aftësinë punuese para përfundimit të saj, është i obliguar Qendrës për punësim t'ja kompenzojë mjetet në afat prej 8 ditësh nga dita e ndërprerjes së aftësisë punuese me kamatë ligjore për vonesë.

Punëdhënësi është i obliguar ti kthejë mjetet e pranuar për personin invalidor me të cilin pas përfundimit të aftësimin të punës me sukses nuk ka themeluar gjegjësisht ka themeluar marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar, ndërsa të cilit i ka pushuar marrëdhënja e punës jo nga faji i personit me hendikep, para skadimit të një viti nga dita e themelimit të marrëdhënjes së punës.

Pas themelimit të marrëdhënjes së punës, punëdhënësi nuk mundet ta zvogëlojë numrin e të punësuarve me hendikep për kohë të pacaktuar në afat prej një viti. Përveç në rast kur marrëdhënja e punës pushon me fuqi të ligjit ose në rast vdekje.

Punëdhënësi është i obliguar ti kthejë mjetet e pranuar për punësimin e personave me hendikep të cilët janë aftësuar për punë nëse ju pushon marrëdhënja e punës para skadimit të një viti nga dita e themelimit të marrëdhënjes së punës, përveç me fuqi të ligji ose në rast vdekje.

Neni

22

Personi me hendikep i cili me fajin ose dëshirën e tij do ta ndërprejë aftësinë punuese është i

---

obliguar që Qendrës për punësim t'ja kompenzojë mjetet në afat prej 8 ditësh nga dita e ndërprerjes të aftësisë punuese me kamatë ligjore për vonesë dhe i njejti fshihet nga evidenca e personave të papunësuar dhe mundet përsëri të paraqitet pas skadimit të një viti.

Personi me hendikep i cili me sukses do ta kryejë aftësinë punuese dhe themelon mardhënje pune në kohë të pacaktuar dhe nëse në afat prej një viti nga dita e themelimit të mardhënjes së punës i pushon e njejta, me dëshirë apo faj të tij, është i obliguar që Qendrës për punë ti kompenzojnë mjete së bashku me kamatë ligjore për vonesë.

Neni

23

Kërkuesi

i mjeteve nga Fondi i veçantë për aftësim pune të cilit i janë ndarë mjete, përsëri mundet të parashtrijë kërkesë për ndarje të mjeteve pas skadimit të një viti nga dita e punësimit të personit me hendikep i cili është udhëzuar në aftësim pune, përveç në aftësim pune të më personave të punësuar me hendikep.

Neni

24

Kjo

Rregullore hynë në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në „Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë“.

Nr.

02-592 Kryetar

5

gusht 2004 Jasmina Dellçeva Dizdareviq, v.d

---

Propozim  
Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Punësim të  
Personave  
me hendikep

LIGJI  
PËR

NDRYSHIM DHE PLOTËSIM TË LIGJIT  
PËR  
PUNËSIM TË PERSONAVE ME HENDIKEP

Neni

1

Në ligjin për punësim të personave me hendikep („Gazetë zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ numër 44/2000, 16/2004), në nenin 1 pas fjalëve: „veti të punëdhënësit“ shtohen fjalët: „në administratën shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes lokale, ndërmarjet publike, entet, agjencionet dhe fondet dhe institucionet tjera shtetërore“.

Neni

2

Në nenin 2 paragrafi 1 fjalët: „person me të meta të lehta në zhvillimin psikik“ zëvendësohen me fjalët: „person me të meta në zhvillimin intelektual“, fraza zëvendësohet me lidhëzën „dhe“, ndërsa fjalët: „dhe person me psikoza“ shlyhet.  
Pas paragrafit 1 shtohet paragraf i ri 2, i cili thot:  
„Person me hendikep llogaritet edhe hedikepi i punës me aftësi pune të mbetur ose të zvogluar dhe nëse është i evidentuar në Agjencionin për punësim i Republikës së Maqedonisë (në tekstin e më tutjeshëm: Agjencionin) si person i pa punësuar“.

Në paragrafin 2 i cili bëhet paragraf 3 pas fjalës „person“ vihet presje dhe shtohen fjalët: „prindëri i tij dhe tutori“.

Neni

3

Në titullin e kreut II fjalët „KUSHTE TË VEÇANTA DHE PRIVILEGJE“ zëvendësohen me fjalët: „MASAT PËR PËRMIRSIMIN E KUSHTEVE“.

Neni

4

Në nenin 4 në fjalinë hyrëse fjalët „kushte të veçanta dhe privilegje“ zëvendësohen me fjalët „Masa për përmirsimin të kushteve“.

Alinea  
1 zëvendësohet dhe thot:

„-  
ndarja e mjeteve të pakthyera për punësim në kohë të pacaktuar të personit të papunësuar me hendikep, adaptim i vendit të punës në të cilin do të punojë personi me hendikep nëse ajo është e nevojshme dhe furnizim i pajisjes sipas kriteriumeve dhe në

mënyrë të caktuar me akt të ministrit për punë dhe politikë sociale“.

Neni

5

Në

nenin 4 paragrafi 1 pika shlyhet dhe shtohen fjalët: „dhe nëse nuk ka vlerësim të aftësisë punuese nga komisioni nga neni 2 paragrafi 3 i këtij ligji se mund ti kryen punët në vendin përkatës të punës“

Paragrafi

2 ndryshohet dhe thot:

„Personi

invalidor mund të bëhet punëdhënës,nëse

fiton mendim pozitiv nga komisioni nga neni 2 paragrafi 3 i këtij ligji.“

Neni

6

Pas

nenit 4-a shtohet nen i ri 4-b, i cili thot:

„Neni

4b

Punëdhënësi është

i obliguar që personit të punësuar me hendikep ti paguajë rrogë në pajtueshmëri me ligj, kontratën kolektive dhe kontratë për punë.

Rrogën

nga paragrafi 1 i këtij neni punëdhënësi është

i obliguar personit të punësuar me hendikep që t'ja paguajë në llogari rrjedhëse ose librezë kursimi, ndërsa rrogën mundet ta ngrejë vetëm personi me hendikep, bashkëshorti-ja, prindi i tij ose tutori i tij “

Neni

7

Neni

6 ndryshon dhe thot:

„Mjetet

për përmirsimin e kushteve për punësim dhe punë të personit me hendikep, adaptim i vendit të punës dhe furnizimit të pajisjes, sigurohen nga Fondi i veçantë për përmirsimin e kushteve për punësim dhe punë të personave me hendikep (në tekstin e mëtutjeshëm: Fond i veçantë).“

Neni

8

Në

nenin 7 pas paragrafit 2 shtohet paragrafi 3, i cili thot:

„Buxheti

i Republikës së Maqedonisë për qëllimet nga paragrafi 2 i këtij neni, mjetet i siguron më së shumti në lartësi të kontributeve në bazamentin e dy neto rrogave mesatare të paguara në Republikën e Maqedonisë në muajn paraprak. Për dallimin nga neto

rroga e cila e tejkalon këtë shumë, mjetet për kontribute i paguan punëdhënësi.“

Neni

9

Neni

9 ndryshon dhe thot:

„Përshkak

punësimit të personit me hendikep themelohen shoqata mbrojtëse si shoqata tregtare. Shoqatë mbrojtëse mund të themelohet nëse punëson së paku pesë punëtorë në kohë të pacaktuar nga të cilat së paku 40% janë persona me hendikep nga numri i përgjithshëm i të punësuarve, nga të cilët së paku gjysma janë persona me hendikep të caktuar në kuptim të nenit 2 paragrafi 1 nga ky ligj. Shoqata mbrojtëse e re është e obliguar në periudhë prej 90 ditëve të punësojë të gjithë punëtorët llogaritur nga dita e punësimit të parë të punëtorit në kohë të pacaktuar në shoqatën, në të kundërtën nuk e fiton statutin e shoqatës mbrojtëse edhe në pesë vitet e ardhshme nuk mundet të punojë si shoqatë mbrojtëse, në cilin afat themeluesi ose anëtari i familjes më të ngushtë nuk mundet të themelojë shoqatë tjetër mbrojtëse.

Shoqata

mbrojtëse nëse nuk i plotëson kushtet nga paragrafi 1 i këtij ligji në periudhë prej 90 ditëve, nuk e humbë statutin e shoqatës mbrojtëse. Nëse shoqata mbrojtëse më shumë se tre herë në dy vitet e fundit e then përqindjen minimale të personave me hendikep ose bjen nën numrin minimal nga numri i përgjithshëm i punëtorëve të punësuar në kohë të pacaktuar të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, e humb statutin e shoqatës mbrojtëse dhe pesë vitet e ardhshme nuk mundet të punojë si shoqatë mbrojtëse në të cilin afat themeluesi ose anëtar i familjes më të ngushtë nuk mund të themelojë shoqatë të re mbrojtëse.

Nëse

shoqata mbrojtëse mbi 90 ditë nuk i plotëson kushtet nga paragrafi 1 i këtij neni e humb statutin e shoqatës mbrojtëse dhe tre vitet e ardhshme nuk mundet të punojë si shoqatë mbrojtëse në të cilin afat themeluesi ose anëtar i familjes më të ngushtë nuk mund të themelojë shoqatë të re mbrojtëse.“

Neni

10

Në

nenin 10 paragrafi 1 pas fjalës „persona“ shtohen fjalët „edhe invalidë të punës“.

Neni

11

Në

nenin 12 paragrafët 2 dhe 4 fjala „Enti“ zëvendësohet me fjalën „Agjencioni“.

Neni

12

Në

nenin 12-a paragrafi 1 fjala „Ent“ zëvendësohet me fjalën „Agjencion“.

Pas

paragrafi 1 shtohet paragraf 2, i cili thot:

„Agjencioni

është i obliguar të mbajë evidencë të

personave të pa punësuar me hendikep në Republikën

“

Në

nenin 2 i cili bëhet paragraf 3 pika shlyhet dhe shtohen fjalët:

„dhe nëse ka vlerësim të aftësisë punuese

se mundet ti punojë punët në vendin përkatës

të punës“.

Neni

13

Në

nenin 13 pas fjalës „paragraf“ numri „2“ zëvendësohet me numrin „3“.

Neni

14

Në

titullin e kreut IV fjala „SIGURIM“ zëvendësohet me fjalën „PËRMIRSIM“.

NENI

15

Në

nenin 15 paragrafi 1 ndryshohet dhe thot:

„Përshkak

të finansimit, të punëve për përmirsimin e

kushteve për punësim dhe punën e personave me

hendikep, adaptim i vendit të punës dhe furnizim i pajisjes

10% nga realizimi i përgjithshëm i mjeteve nga kompenzimi i

përhershëm për punësim ndahen në

nënlllogarinë e Agjencionit (Fondi i veçantë) më

së voni deri më 30 të muajt për muajn e kaluar.“

Paragrafi

2 shlyhet.

Në

paragrafet 3 dhe 4 të cilët bëhen paragrafë 2 dhe

3 fjala „Enti“ zëvendësohet me fjalën

„Agjencioni“, ndërsa fjala „i obliguar“ ngel e njejtë

(sa i përket përkthimin në gjuhën shqipe).

Neni

16

Në

nenin 16 paragrafi 1 fjala „Enti“ zëvendësohet me fjalën „Agjencioni“.

Pas

paragrafit 1 shtohen tre paragrafë të ri 2, 3 dhe 4 të cilët thonë:

„Personit

juridik i cili nuk është shoqatë mbrojtëse, mund ti ndahen mjete nga Fondi i veçantë për personin e punësuar të ri me hendikep nga neni 2 paragrafi 1 i këtij ligji në kohë të pacaktuar dhe adaptim të vendit të punës në të cilin do të punojë personi me hendikep

Shoqatës

mbrojtëse mundet ti ndahen mjete nga Fondi i veçantë për personin e ri të punësuar me hendikep nga neni 2 paragrafi 1 i këtij ligji në kohë të pacaktuar dhe adaptim i vendit të punës në të cilën punon personi me hendikep dhe furnizim të pajisjes.

Personit

me hendikep nga neni 2 paragrafi 1 i këtij ligji kur pamvarsisht kryen veprimtari si tregtar individ mund ti ndahen mjete nga Fondi i veçantë për punësimin e tij për kohë të pacaktuar, adaptim të vendit të punës në të cilën do të punojë dhe furnizim të pajisjes“.

Në paragrafin 2 i cili bëhet

paragraf 5 fjala „Enti“ zëvendësohet me fjalën „Agjencioni“.

Në

paragrafin 3 i cili bëhet paragraf 6 fjala „Enti“ zëvendësohet me fjalën „Agjencioni“.

Në

nenin 4 i cili bëhet paragraf 7 pas fjalës „pajisja“ shlyhen fjalët: „mbindërtim dhe adaptim i hapsirës punuese“, ndërsa fjalët: „krijim i kushteve të veçanta“ zëvendësohen me fjalët „përmirsim i kushteve“.

Neni

17

Në

nenin 16-a paragrafi 1 pika 1 ndryshohet dhe thot:

„personi

i punësuar me hendikep nga neni 2 paragrafi 1 i këtij ligji në kohë të pacaktuar në lartësi prej 20 rrogave mesatare të paguara në Republikën e Maqedonisë për vitin e kaluar para punësimit për punësimin e personit krejtësisht të verbër (person i verbër praktik) dhe personi me hendikep trupor të cilit përshkak të lëvizjes i njevojitet karrocë invalide:;“

Në

pikën 2 fjalët „30 rroga mesatare të paguara në Republikën e Maqedonisë për muajn paraprak para parashtrimit të kërkesës“ zëvendësohet me fjalët „100.000 denarë“, ndërsa pika dhe presja zëvendësohen me lidhësen „dhe“.

Pika

3 ndryshon dhe thot: „furnizim i pajisjes në lartësi prej 20 rrogave mesatare të paguara në Republikën e Maqedonisë në vitin e kaluar, gjatë së cilës kërkuesi në vlerë llogaritëse të programës duhet të merr pjesë me pjesmarje të vet prej 20% (mjete pronësore, kredi nga banka ose mjete personale në

pronësi të firmës), ndërsa shuma e mjeteve të ndara mund të jetë më së shumti në lartësi të pronës dhe kapitalit të përhershëm e verifikuar në librin e kërkesës (investim themelor, objekte ndërtimore dhe afariste, dyqane dhe të ngjajshme) dhe parashtron hipotekë në raport 2:1 ose garancion bankar të jetë me vlershmëri deri së paku tre vjet .“

Pika  
4 shlyhet.

Në  
paragrafin 2 fjalët : „pika 3 dhe 4“ zëvendësohen me fjalët: „pika 3“.

Paragrafi  
3 ndryshon dhe thot:

„Parashtruesi  
i kërkesës mund të shfrytëzojë mjete nga Fondi i veçantë për qëllimet e paragrafit 1 pika 1 e këtij neni nën kushte të caktuara në Ligjin, nëse veprimtarisht është aktiv, ka bonitet pozitiv që shihet me dokumente të dhëna nga institucioni përkatës dhe pagim të rregullt të rrogave për nëntë muajt e fundit llogaritur nga dita e punësimit të personit të hendikepuar dhe parashtron hipotekë ose garancion bankar me afat të aritjes prej 11 muaj në lartësi të mjeteve që i kërkon nga Fondi i veçantë për punësimin e personit me hendikep. Garancioni bankar, gjegjësisht hipoteka do të aktivizohet nëse punëdhënësi e zvoglon numrin e përgjithshëm të personave me hendikep nga neni 2 paragrafi 1 i këtij ligji ose nuk ju paguan rrogë më tepër se 90 ditë.“

Paragrafi  
4 zëvendësohet me dy paragrafe të reja 4 dhe 5, të cilat thonë:

„Me  
përrjashtim të paragrafit 3 nga ky nen nëse parashtruesi i kërkesës nuk vë hipotekë ose garancion bankar në lartësi të mjeteve që i kërkon nga Fondi i veçantë për punësimin e personit me hendikep do ti paguhet 50% nga mjetet e lejuara, ndërsa pjesa tjetër do ti paguhet dhjetë muajt e ardhshëm në dhjetë këste të njehta, obligimi për parashtrimin e hipotekës ose garancionin bankar nuk i përket administratës shtetërore, njësisive të vetëqeverisjes lokale, ndërmaejt publike, entet, agjencionet dhe fondet dhe institucionet shtetërore.

Parashtruesi  
i kërkesës mundet të shfrytëzojë mjete për qëllime nga pika 3 i këtij ligji, nëse veprimtarisht është aktiv më tepër se 3 vjet.“

Në  
paragrafin 5 i cili bëhet paragraf 6 pas numrit 2 presja zëvendësohet me lidhësen „dhe“, ndërsa pas numrit 3 fjalët: „dhe 4“ shlyhen.

Në  
paragrafin 6 i cili bëhet paragraf 7 numri „3“ zëvendësohet me numrin „4“.

Neni  
18

Në  
nenin 16-b paragrafi 1 pas fjalës „persona“ shtohen fjalët:  
„nga neni 2 paragrafi 1 i këtij ligji“, ndërsa fjala

„Enti“ zëvendësohet me fjalën „Agjencioni“.

Paragrafi

3 ndryshon dhe thot:

„punëdhënësi

mundet të shfrytëzojë mjete nga Fondi i veçantë për punësimin e personit me hendikep nga neni 2 paragrafi 1 i këtij ligji, nëse në evidencën e agjencionit udhëhiqet si person i papunësuar me hendikep nga neni 2 paragrafi 1 i këtij ligji për të cilin janë shfrytëzuar mjetet për punësim nga Fondi i veçantë, gjatë punësimit përsëri punëdhënësi i ri nuk mundet të shfrytëzojë mjete nga Fondi i veçantë për punësim të personit me hendikep para skadimit të pesë viteve llogaritur nga dita e themelimit të marëdhënjes së re të punës“.

Në

paragrafin 6 në reshtin e parë pas fjalës „persona“ shtohen fjalët „nga neni 2 paragrafi 1 i këtij ligji“.

Paragrafi

8 shlyhet.

Neni

19

Në

nenin 18 paragrafi 1 fjala „Enti“ zëvendësohet me fjalën „Agjencioni“.

Në

nenin 2 fjalët : „Enti është i obliguar“ zëvendësohet me fjalët „Agjencioni është i obliguar“.

Neni

20

Në

nenin 20-a paragrafi 1 fjalët „1, 7 dhe 8“ zëvendësohen me fjalët „1 dhe 7“.

Neni

21

Në

nenin 22 numri „6“ zëvendësohet me fjalët: „16-a paragrafi 6“.

Neni

22

Në

nenin 23 numri „6“ zëvendësohet me fjalët: „16-a paragrafi 6“.

Neni

23

Në

nenin 24 „Enti“ zëvendësohet me fjalën „Agjencioni“, ndërsa fjalët „2 dhe 3“ zëvendësohen me fjalët „5 dhe 7“.

---

Neni  
24  
Ministria  
për punë dhe politikë sociale në afat prej 60  
ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji  
do ta sjellë aktin nga neni 4 i këtij ligji.

Neni  
25  
Kërkeseat  
e parashtruara për shpërndarjen e mjeteve nga Fondi i  
veçantë të cilat nuk janë zgjidhur nga dita e  
hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të zgjidhen  
sipas dispozitave të ligjit i cili ka qenë në fuqi  
para parashimit të kërkesës.

Neni  
26  
Mjetet  
nga neni 15 paragrafi 1 i këtij ligji do të ndahen duke  
filluar prej 1 janari 2007.

Neni  
27  
Autorizohet  
Komisioni Juridiko-ligjdhënës i Kuvendit të Republikës  
së Maqedonisë të përcaktojë tekst të  
pastruar të Ligjit për punësimin e personave me  
hendikep.

Neni  
28  
Ky  
ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në  
„Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë“.